



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 53 prot.

Himarë, më 28.07.2023

**PROCESVERBAL I ZBARDHUR NGA ORGJINALI MBI ZHVILLIMIN E  
MBLEDHJES PËR MUAJIN KORRIK ,DATË 28.07.2023**

**Mbledhja e Këshillit Bashkiak Himarë për muajin korrik datë 28.07.2023,ora 10:30**

**1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:**

Gjergji Iliadhi, Elisabeta Lamaj, Nikolin Laska, Dhimitër Kapaj, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Nertila Husi, Mirka Gjiçali, Artionil Shirokaj, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Qirjako Mërkuri, Lenica Kocani, Miltiadh Prifti, Thëllëza Kokaveshi, Afrovita Dhimojani.

**2. Mungojnë: Maks Vlashi,Artan Bala ( me arsye)**

Në mbledhje marrin pjesë të ftuar:

Drejtoritë e drejtorive,kryetarët e fshatrave,administratorët e njësive të Bashkisë Himarë.  
Sigurohet mbi 50% pjesëmarrja e këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari i Këshillit Z.Dhimitër Kapaj

Komunikohet këshilltarëve shprehja e ligjshmërisë të vendimeve për muaj qershor,nga Prefektura Qarku Vlorë (Sekretarja,Elena Memushaj)

Këshilltarët:-nuk është e nevojshme i kemi marr vendimet.

**3.Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryetari Këshillit:-** Jeni dakort me rendin e ditës?

Me leje? Afrovita Dhimojani:Nuk jemi dakort me pikat e rendit të ditës sepse pika 8 e rendit të ditës duhet të ishte pikë e parë.

**Kryetari këshillit:-** Kur të zgjedhim komisionet dhe në mbledhjen e ardhshme në bazë të ligjit do të konstatojmë ,këshilli ka një rregullore të cilën do ta shqyrtojmë,diskutojmë në këtë mbledhje për ta ligjzbatuar në mbledhjet në vazhdim.

**Këshilltarja Afrovita Dhimojani:-**Duhet protokolluar kryetarët e grupeve të Këshillit Bashkiak. **Kryetarët e grupeve: Kryetare e grupit Bashkë Fitojmë,Afrovita Dhimojani.**

**Kryetar i grupit Partia Socialiste,Mirka Gjijali.**

**Miratohet nga këshilltarët kryesia e grupeve të Këshillit Bashkiak Himarë 2023.**

**Pika 1 e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i projektvendimit për rregulloren e Këshillit Bashkiak Himarë.**

**Kryetari Këshillit:-**Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat qe do të ndiqen në këshill.

**Afrovita Dhimojani:-** Me sa pashë rregullorja është e përshtatur gati si çdo këshill bashkiak,pika 1 e nenit 9 ka nevoj për ndryshim dhe neni 32 ka nevojë për ndryshim.

**Kryetari Këshillit:-**jeni dakort për ndryshimet? Po këshilltarët.

**Këshilltarja Silva Burbo:** Me leje ? Tek rregulloret dhe strategjitë që voton këshilli ,shtojza 17 rregullore e Këshillit Bashkiak,pse nuk zbatohet,për plazhet a ka ndonjë plan përcaktimi,strategjie për turizmin?

**Këshilltarja ,Loreta Isufi: -** Me leje kryetar,t'i përgjigjem unë? Po :- kryetari .

Të gjitha subjektet monitorohen nga Ministria e Turizmit dhe nuk është në kompetencën e këshillit dhe Bashkisë.

**Këshilltari ,Fuat Mati:-**Zhvillimi turistikë është bërë në bazë të infrastrukturës që ka bërë shteti por dhe Bashkia ka kompetencë dhe kam dhe diçka tjetër për të shtuar,kryetarët e fshatrave duhet të jenë të ftuar në mbledhjet e këshillit në mënyrë që të trajtojnë çështjet në fshatrat e tyre të cilat ne i diskutojmë këtu.

**Kryetari dhe Sekretari i Këshillit:** Kryetarët e fshatrave janë të lajmëruar .

**Këshilltari ,Miltiadh Prifti:-** Me leje? Turizmi është zhvillimi i të ardhmes së vendit tonë,propozoj të kemi një komision për turizmin.

**Kryetari Këshillit:-**në rregull,është dakort këshilli?

**Këshilli:-**Dakort,e miratojmë.

**Kryetari Këshillit:-**Jeni dakort me rregulloren?

**MIRATOHET VENDIMI NR 33 “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË (me ndryshimin ku në komisionin e shërbimeve mbështetëse ( arsimit,kultura,rinia,sporti futet dhe turizmi,me ndryshim në pikën 1 të nenit 9 dhe nenit 32 të rregullores) ME 19 VOTA PRO**

**Pika 2 e rendit të ditës**

**Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe përbërja e tyre”.**

**Këshilltarja Afrovita Dhimojani:-**Në bazë të rregullores kërkojmë 1/3 e komisioneve për sa na takojnë,dy grupe ,i ndajmë me konsensus.

Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë.

Propozon kryetarja e grupit socialist Mirka Gjiçali, emrat e anëtarëve të komisionit.

Propozon kryetaria e grupit BF Afrovita Dhimojani, emrat e anëtarëve të komisionit.

Grupet nuk bien në konsensus dhe Kryetari Këshillit kërkon 5 min pushim në mënyrë që të konsultohen grupet me njëri -tjetrin.

Zgjidhet kryesia e këshillit për zgjedhjen e komisioneve.

Kryetari i Këshillit,Z.Dhimitër Kapaj,Kryetarja e grupit BF Znj: Afrovita Dhimojani,Kryetarja e grupit të PS Znj: Mirka Gjiçali,Nënkryetarët e Këshillit Z.Milto Nika dhe Z.Timoleo Gërdhuqi.Nga mbledhja e grupit të komisioneve ranë në konsensus në bazë të rregullores së këshillit që 2 komisione

1-komisioni i zhvillimit urban,infrastrukturës dhe shërbimeve publike që ta marr opozita,BF.

2-Komisioni i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale ta marr opozita ,BF.

**Kryetari Këshillit:- E hedhim në votim?**

**MIRATOHET VENDIMI NR 34 “MBI KRIJIMIN E KOMISIONEVE DHE PËRBËRJEN E TURE”.**

**1.Komisioni ekonomisë financës dhe auditit.**

1- Gjergj Iliadhi Kryetar

2- Miltiadh Prifti Nënkryetar

3- Silva Burbo Anëtarë

4-Loreta Isufi Anëtarë

5- Maks Vlasi Anëtarë

**2.Komisioni bujqësisë,pyjeve,kullotave dhe aseteve të Bashkisë.**

1-Milto Nika Kryetar

2-Fuat Mati Nënkryetar

3- Thodhori Foto Anëtarë

4- Silva Burbo Anëtarë

5- Mirka Gjiçali Anëtarë

**3.Komisioni i shërbimeve mbështetëse ( arsimi,kultura,rinia,sporti,turizmi)**

1-Artionil Shirokaj Kryetar

2-Thëllëza Kokaveshi Nënkryetar

3- Elisabeta Lamaj Anëtarë

4-Thodhori Foto Anëtarë

5- Lenica Kocani Anëtarë

#### **4.KOMISIONI I ZHVILLIMIT URBAN,INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE.**

1-Timoleo Gërdhuqi	Kryetar
2- Qirjako Mërkuri	Nënkryetar
3-Artionil Shirokaj	Anëtarë
4- Afrovita Dhimojani	Anëtarë
5- Aleks Llazari	Anëtarë
6- Artan Bala	Anëtarë
7- Gjergj Iliadhi	Anëtarë

(Ky komision u dakortësua të jetë me 7 anëtarë nga këshilli me kërkesë të këshilltares Silva Burbo)

#### **5.KOMISIONI I BARAZISË GJINORE,PËRFSHIRJES SOCIALE.**

1- Afrovita Dhimojani	Kryetar
2- Maks Vlashi	Nënkryetar
3- Nertila Husi	Anëtarë
4- Loreta Isufi	Anëtarë
5- Thëllëza Kokaveshi	Anëtarë

#### **PIKA 3 E RENDIT TË DITËS**

**SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTVENDIMIT “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.56.DATË 24.11.2022 “PËR MIRATIMIN E NR TË PËRGJITHSHËM DHE NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARE PËR VITIN 2023”.**

Këshilltarët e opozitës : pikat e rendit të ditës nuk kanë kaluar në komision. Pasi të kalojnë në komision i shqyrtojmë.

**Kryetari Këshillit :- Jeni dakort që pikën 3,4,dhe 5 të rendit të ditës të lem një mbledhje jashtë radhe edhe pasi të kalojnë në komision i shqyrtojmë?**

**Këshilltarët :-** Kalojmë projektvendimin e pagave dhe ndihmën ekonomike.

**Kryetari Këshillit:-** jo ,nëse jeni dakort për të tria pikat të lëmë një mbledhje jashtë radhe.

**Këshilli :-** Në rregull.

**NUK MIRATOHET PIKA 3 E RENDIT TË DITËS.**

**PIKA 4 E RENDIT TË DITËS.**

**SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I MARRËVESHJES NR 3252.PROT.DATË 1R.07.2023 TË PROTOKOLLIT TONË DHE NR 5946 PROT.DATË 14.07.2022 TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË LUDHUR MIDIS BASHKISË HIMARË ,BASHKISË VLORË ,BASHKISË SELENICË ME OBJEKT: MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË**

**NUK MIRATOHET PIKA 4 E RENDIT TË DITËS,LIHET PËR NË MBLEDHIJEN MË TË AFËRT ASHTU SI DHE KËSHILLI DHE KRYETARI DAKORTËSUAN.**

**PIKA 5 E RENDIT TË DITËS**

**SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTVENDIMIT “PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE BUXHETORE MBI EFEKTIN E RITJES SË PAGAVE”.**

**NUK MIRATOHET PIKA 5 E RENDIT TË DITËS ,ASHTUSIKURSE DAKORTËSOI KËSHILLI ME KRYETARIN.**

**KRYETARI KËSHILLIT:- Jeni dakort me ndihmat ekonomike,i kalojmë?**

**PIKA 6 E RENDIT TË DITËS.**

**MIRATOHET VENDIMI NR.35 PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE,PERIUDHA 1- 31 MAJ 2023 ,NGA FONDI 6% I BLOK- NDIHMËS EKONOMIKE.**

**PIKA 7 E RENDIT TË DITËS.**

**MIRATOHET VENDIMI NR.36 PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN 1-30 QERSHOR 2023,NGA FONDI 6% I BLOK – NDIHMËS EKONOMIKE.**

**PIKA 8 E RENDIT TË DITËS.**

**Kryetari Këshillit:- Vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës**

**Ceremonia e marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Himarë Z.Fredi Beleri**

- a- Deklarimi i vleshmërisë se mandatit të Kryetarit .
- b- Kryerja e betimit

Këshilltarja Afrovita Dhimojani lexon vleshmërinë e mandatit të Kryetarit nga KQZ dhe vleshmërinë nga gjykata e rrethit Vlorë,në vijim kërkon t'i mundësohet betimi Z.Beleri nëpërmjet rrjeteve sociale ose në vendndodhjen e tij. Ne si këshilltar duhet ta ndjejmë si detyrim moral dhe të respektojmë verdiktin e çdo votuesi

Himarjot,bashkohen njëzëri këshilltarët e BF ,në sallë të Këshillit ka duartrokitje dhe brohoritje,bëhet e zhurshme mbledhja.

**KRYETARI KËSHILLIT** :- Citon nenin 60 pika 3 të ligjit 139/2015 të vetëqeverisjes vendore.

**Këshilltari,Artionil Shirokaj:-** Ligji e thotë qartë, kur thotë : vleshmëria e mandatit të kryetarit ndodh në momentin kur kryetari bën betimin

**Kryetari Këshillit:-** nuk ka bazë ligjore për këtë kërkesë ,bie poshtë kërkesa dhe mbledhja mbyllet.

**Të ndryshme**

---

**Sekretari**  
**Elena Memushaj**

